

VENDIM
Nr. 13, datë 31.1.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË RTS SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME FUQI TË
INSTALUAR 2 mw, NË FSHATIN TREN, BILISHT TË RRETHIT KORÇË**

(Ndryshuar me vendimin nr. 232, datë 30.9.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1 germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 31.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë me fuqi të instaluar 2 mw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 258, datë 17.12.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me fuqi të instaluar 2 mw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 55/72, datë 17.12.2018, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 747/1 prot., datë 21.12.2018, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit për fillimin e procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim i cili konsiston si më poshtë:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, (neni 9, pika 2):

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë). Mungojnë vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për subjektin RTS sh.p.k.

- germa “g”, dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e veprimtarisë së licencuar). Sa i përket kësaj kërkesë subjekti ka paraqitur në ERE Kontratën e Qirasë nr. 1890 rep. dhe nr. 1077/3 kol., datë 11.9.2018, të lidhur me qiradhënësin Bashkia Devoll, për sipërfaqen 63.915 m² (pronë shtetërore), për një afat 20-vjeçar, por në të cilën nuk parashikohet e drejta e përsëritjes. Në lidhje me këtë dokument, iu kërkua subjektit sqarimi përkatës për periudhën e mbetur 5-vjeçare, që nuk mbulon kontrata e qirasë, duke qenë se nga studimi i fizibilitetit rezulton se jetëgjatësia e paneleve është parashikuar të jetë 25 vjet.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3):

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime): Mungon vërtetimi për kontributet e sigurimeve shoqërore.

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Mungon dokumentacioni mbështetës për financimin nga ortakët.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria RTS

sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria RTS sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 19/1, datë 18.1.2019, ka përcjellë në ERE plotësim dokumentacionit.

- Aplikimi i shoqërisë RTS sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”, 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”, si dhe pika 4.4.5, gjerat “a” dhe “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Subjekti RTS sh.p.k. ka lidhur kontratën me nr. 2156 rep. dhe nr. 115/6 kol., datë 8.10.2018, me MIE për një afat 49-vjeçar (dizetentëvjeçar), por nga ana tjetër sqarojmë se, ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Por duke qenë se nga të dhënat për projektin e impiantit rezulton se jetëgjatësia e pritshme e një paneli është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për një licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë RTS sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaike, me fuqi të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatın Tren, Bilisht të Rrethit Korçë, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti